

UDHËZIM
Nr. 224, datë 11.4.2017

**PËR RREGULLAT PËR KRYERJEN E INSPEKTIMEVE NGA POLICIA E SHTETIT,
PËR MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË MASAVE SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shitesë të sigurisë publike”,

UDHËZOJ:

1. Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të saj, kryen inspektime në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për monitorimin e përmbushjes së masave shitesë të sigurisë, nga subjektet publike dhe private, në varësi të llojit dhe nivelit të masës së sigurisë, të përcaktuar nga komisioni i vlerësimit të masave të sigurisë.

2. Për kryerjen e inspektimit, hartohet plani i inspektimit, i cili miratohet nga drejtuesi i strukturës vendore të policisë, në të cilin përcaktohen:

- a) grupi i inspektimit i policisë së shtetit;
- b) territori, subjektet dhe/ose objektet që do të inspektohen;
- c) kohëzgjatja e kryerjes së inspektimit;
- d) masat shitesë që janë përcaktuar për çdo subjekt nga komisioni përkatës;
- e) mënyra e funksionimit të masave shitesë të sigurisë, sipas llojit të masës së parashikuar për subjektin që inspektohet.

3. Pas miratimit të planit të inspektimit, përgjegjësi i grupit të inspektimit të strukturës vendore të policisë njofton subjektin që do të inspektohet. Nëse do të inspektohet një ndërtesë banimi, në këtë rast njoftohet, struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe administratori apo sipas rastit, shoqëritë e administrimit të ndërtesave të banimit apo pronarët e objekteve.

4. Gjatë inspektimit në një subjekt, grupi i inspektimit ka të drejtë të verifikojë funksionimin e masave shitesë të sigurisë, sipas llojit të masës që detyrohet të zbatojë, konkretisht:

- a) funksionimin e sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike deri në 2 muaj;
- b) funksionimin e pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikim, si dedektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.;
- c) lidhjen e sinjalit të alarmit të bankave dhe objekte të rëndësishme shtetërore, në nivel qendror dhe vendor me sallat e komandimit të policisë së shtetit;
- d) kontraktimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe respektimin e standardeve të kërkuara;
- e) funksionimin e kombinuar të disa masave shitesë të sigurisë publike.

5. Për kryerjen e inspektimit, grupi i inspektimit do të hyjë në objektet që do të inspektohen, ose në ambientet ku mbahen pajisjet regjistruese apo të identifikimit dhe do të mbikqyrë nëse pajisjet janë funksionale, në prani të subjektit që kontrollohet apo personit përgjegjës.

6. Grupi i inspektimit përbëhet nga jo më pak se tre punonjës policie. Gjatë inspektimit, mund të marrin pjesë edhe persona të caktuar nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore. Pas inspektimit, grupi i inspektimit, i propozon drejtuesit të strukturës vendore të Policisë, masat administrative që duhen marrë.

7. Në përfundim të inspektimit, konkluzionet i njoftohen edhe subjektit të inspektuar, si dhe bazuar në aktin e inspektimit, lihen për zbatim detyra, brenda afateve të caktuara, me qëllim që masat shitesë të sigurisë të jenë funksionale dhe efektive, si dhe përcaktohet data e rikontrollit të detyrave të lëna.

8. Në përfundim të inspektimeve të kryera, sipas planit të inspektimit, nga struktura vendore e policisë hartohet një raport i plotë, ku përshkruhen veprimet e kryera, konstatimet, detyrat e lëna, si dhe masat administrative të marra. Raporti i dërgohet drejtorisë përkatëse në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

9. Ngarkohet Drejtoria e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.
Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Fatmir Xhafaj